

KURS TRAJNIMI

KAMPIONIMI DHE PROCEDURAT LABORATORIKE PER UJIN E PIJSHEM DHE TE NDOTUR

Përshkrimi i kursit

Njohja e procedurave laboratorike si dhe zbatimi i duhur i tyre është një domosdoshmëri për të gjithë shoqëritë UK. Kampionimi si dhe analizat laboratorike janë përfaqësuese të të gjithë sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, përsa i përket cilësisë së ujit dhe sigurisë së konsumatorëve.



Ky kurs trajnimi ka për qëllim të shpjegoj procedurat laboratorike, të identifikojë pajisjet e nevojshme për ti kryer ato, procedurat e kampionimit si dhe të tregoj hapat e duhura për kryerjen e analizave laboratorike të nevojshme.

Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për punonjësit e laboratorit.

Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, ju do të jeni të aftë të:

- Punoni të sigurt në laborator;
- Njihni dhe përdorni pajisjet laboratorike në mënyrën e duhur;
- Identifikoni rreziqet e mundshme gjatë punës në laborator;

- Përdorni dhe plotësoni një fletët e punës për regjistrimin e të dhënave;
- Identifikoni aparaturat dhe teknikat e marrjes së mostrave;
- Realizoni kushtet e nevojshme gjatë analizave laboratorike;
- Kryeni analizat laboratorike si: alkaliniteti, klori residual, nevojë për klor, koliformet, fortësinë e ujit, ph-in, temperaturën dhe turbiditetin.

Metoda e trajnimit

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në Power Point, të ndërthurura me diskutime dhe raste studimore. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë edhe raste konkrete studimore.

Materialet e kursit

Si pjesëmarrës në këtë kurs, ju do të pajiseni me Manualin e Trajnimit për Procedurat Laboratorike dhe Marrjen e Mostrave për Ujin e Pijshëm. Përpos kësaj, ju do të pajiseni me çertifikatë e cila dëshmon pjesëmarrjen tuaj në këtë trajnim.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB dhe SHUKOS:
13,000 lekë ose 95 euro për person.
Jo-anëtarët: 16,000 lekë për person.

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.

KURS TRAJNIMI

KAMPIONIMI DHE PROCEDURAT LABORATORIKE PËR UJIN E PIJSHËM DHE TË NDOTUR

FORMULAR REGJISTRIMI

Emër Mbiemër _____

Datëlindja _____

Institucioni _____

Pozicioni _____

Edukimi _____

Celular _____

E-mail _____

Ju lutem, plotësoni këtë formular dhe dërgojeni në adresën e e-mailit shukos2001@gmail.com ose training@shukalb.al brenda datës 15 nëntor.

Pagesën mund ta derdhni në llogarinë bankare të SHUKOS si më poshtë, duke specifikuar emrin tuaj dhe qëllimin e transfertës:

Banka: NLB Prishtina sh.a

Emri i Llogarisë: Shoqata e Ujësllësve dhe Kanalizimit të Kosovës

Numri i Llogarisë: 17-00-200000018975

IBAN: XK05 17-00-2000000189 75

SWIFT: NLPR XK PR

Shënim: Pjesëmarrja juaj në këtë aktivitet duhet të konfirmohet nëpërmjet e-mailit, telefonit apo postës.